



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova Komuna e Podujevës  
/ Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

# **Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e komunës për vitin 2026**

**Shtator 2025**

## **Tabela e përmbajtjes**

Hyrje .....	3
Emrat e anëtarëve të grupit punues .....	5
Raporti i dëgjimit publik në fshatin Gllamnik.....	7
Raporti i dëgjimit publik në fshatin Dumnicë.....	9
Tabela nga kërkesat e pranuar me email.....	12
Shkurtesat.....	13
Aneks 3 (Njoftimet e publikuar në kuadër të dëgjimeve buxhetore).....	13
Aneks 4 (Materialet e përgadituara për dëgjimie Buxhetore në Podujevë).....	14
Përfundimi.....	15

## Hyrje

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Podujevës Nr.01-020/01-0050862, si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Podujevës ka organizuar dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025. Me datë 15.02.2024 Kryetari i Komunës Shpejtim Bulliqi me vendimin nr 02-20/04-0011571/24 ka caktuar grupin punues i cili sipas UA Nr. 04/2023 ka organizuar dëgjimet dhe ka adresuar kërkesat e pranuar nga qytetarët në dëgjimet buxhetore.

Grupi punues ka mbledhur komentet dhe në takimet e mbajtura me datë 22.09.2025 ka diskutuar kërkesat e qytetarëve dhe ka vendosur për pranimin, refuzimin apo adresimin e tyre.

Sipas standardeve të UA nr 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kriterëve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon

**Pranuar:** *Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës.*

**Pranuar pjesërisht:** *Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës.*

**Refuzuar:** *Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit.*

**Adresuar:** *Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk janë nën kompetencën e Komunës, por nën kompetencat e institucioneve tjera dhe si të tilla vetëm adresohen nga grupi punues në institucione përkatëse.*

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument

është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe word dhe në arkivin e komunës.

Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të komunës dhe Asamblesë së Komunës së Podujevës. Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar, kalendari i dëgjimeve, komunikatat, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si aneksë.

Sipas planit të punës komuna ka organizuar 4 dëgjime buxhetore në të cilat kanë marrë pjesë 13 qytetarë prej të cilëve 11 burra dhe 2 Gra. Grupi punues ka listuar 17 kërkesa prej të cilave 11 janë pranuar, 3 janë refuzuar 3 janë adresuar.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt - buxheti i vitit 2026, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe është proceduar, në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

**Të dhëna të shkurtëra për dëgjimet buxhetore:**

Nr	Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve			Statusi i Kërkesa				
			F	M	T	R	P	PJ	A	T
1	Dëgjimi publik buxhetor në shkollën e fshatit Gllamnik “Kongresi i Manastirit”	08.09.2025	0	7	7	2	10	0	1	13
2	Dëgjimi publik buxhetor në shkollën e fshatit Dumnicë “Lasgush Poradecit”	09.09.2025	2	4	6	1	1	0	2	3
3	Dëgjimi publik buxhetor në shkollën e fshatit Bradash “Nuhi Gashi”	10.09.2025	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Dëgjimi publik buxhetor në Podujevë në sallën e Kuvendit të Komunës	11.09.2025	0	0	0	0	0	0	0	0
			Femra----:2 Meshkuj-:11 Totali-----:13			Refuzuar 3 Pranuar 11 Pjesërisht 0 Adresuar 3 Totali 17.				

Grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026-2028, në këtë përbërje:

EMRAT E ANTARËVE

**Anëtarë të grupit punues janë:**

	Emri mbiemri	Funksioni zyrtar	Pozicioni në grupin punues
1	Fatlum Osmani	Drejtor i DBF-së	Koordinator
2	Adelina Stublla	Drejtoreshë e DSHMS-së	Anëtare
3	Avni Fetahu	Drejtor i DKA-së	Anëtar
4	Mimozë Restelica	Zyrtare për zhvillim DPZHE	Anëtare
5	Liridona Rrahmani	Zyrtare për Informim ZMPI	Anëtare
6	Valmire Rekaliu	Zyrtare operatore DSHPMSH	Anëtare
7	Remzi Kodraliu	Zyrtar për regjistrim të adresave	Anëtar
8	Imer Hoti	Udhëheqës i sektorit në DBPZHR	Anëtar
9	Arianit Shaqiri	Udhëheqës i sektorit të gjendjes civile DA	Anëtar

Grupi punues ka për detyrë që të përgadisë dhe organizojë dëgjimet buxhetore përfshirë hartimin e Planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e

procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ (Mapl) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime radhazi, duke bërë Planin e veprimit për dëgjimet buxhetore, përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim.

Plani i veprimit ka përfshirë organizimin e dëgjimeve publike nga ekzekutivi gjatë periudhës korrik-gusht, si dhe organizimin e dëgjimit buxhetor nga Kuvendi Komunal përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa, 6 shtator.

Ekzekutivi komunal ka organizuar gjithësej 4 dëgjime publike buxhetore. Njoftimi, kalendari, Plani i veprimit dhe një dokument i detajuar mbi buxhetin, janë publikuar në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Podujevës, në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, në rrjete sociale, janë dërguar ftesa përmes rrjeteve sociale, e-maileve dhe direkt përmes thirrjeve telefonike, duke i ftuar pjesëmarrësit që të bëhen pjesë e përgatitjes së buxhetit. (Në annex 1 materialet e publikuara)

### **Raporti me të gjitha detajet: Nga dëgjimi publik në fshatin Gllamnik**

Dëgjimi publik me banorët e fshatit Lluzhan është mbajtur më 08.09.2025, takimi ka zgjatur 1 orë e 5 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 7 persona.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneksë.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 13 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 22.09.2025 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet e takimit dhe procesvebalin në (Aneksin 1).

## KY ËSHTË ARSYETIMI QË E KEMI BËRË NË GLLAMNIK

### 1. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Podujevës, saktësisht me banorët e fshatit Gllamnik dhe fshatrave përreth, takimi i mbajtur në shkollën “Kongresi i Manastirit”

-08.09.2025 – Ora 17:00

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht Adresuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1. Kërkesë për ndërtimin e sallës së educates fizike	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës. Grupi punues ka vlerësuar që kërkesën ta përfshijë në buxhetin e vitit 2026.	DKA
2. Kërkesë për asfaltimin e rrugës që lidh Sfeçlën me Siboc (1.5km)	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës. Grupi punues ka vlerësuar që kërkesën ta përfshijë në buxhetin e vitit 2026.	DPUMM
3.Rregullimi i rrugës “Syl Xhinolli” rrugë e cila nevojitet shumë për banorë që i punojnë arat.	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës. Grupi punues ka vlerësuar që kërkesën ta përfshijë në buxhetin e vitit 2026.	DPUMM
4.Kërkesë për tu asfaltuar rruga në lagjen Toska	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës. Grupi punues ka vlerësuar që kërkesën ta	DPUMM

			përfshijë në buxhetin e vitit 2026.	
5.Kërkesë për tu asfaltuar rruga “5 dëshmorët” deri këtu.	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës. Grupi punues ka vlerësuar që kërkesën ta përfshijë në buxhetin e vitit 2026.	DPUMM
6.Kërkesë për mirëmbajtje të ndriçimit, sepse nuk kanë siguri fëmijët dhe grate.	Osman Bahtiri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij problemi është kompetencë e Komunës së Podujevës, saktësisht drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe andaj kanë vendosur që të përfshijnë në buxhetin e vitit 2026.	DSHPMSH
7. Kërkesë për rregullimin e urës në Gllamnik.	Osman Bahtiri	Refuzuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij kërkesë është kompetencë e Komunës së Podujevës, gjegjësisht kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mirëpo për shkak të kufizimeve buxhetore kjo kërkesë refuzohet.	DSHPMSH

**Raporti me të gjitha detajet: [Nga dëgjimi publik në fshatin Dumnicë](#)**

Dëgjimi publik me banorët e fshatit Dumnicë është mbajtur më 09.09.2025, takimi ka zgjatur 45 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 6 persona.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 4 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 22.09.2025 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet e takimit dhe procesvebalin në (Aneks 1).

## **KY ËSHTË ARSYETIMI QË E KEMI BËRË NË DUMNICË**

### **1. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Podujevës, saktësisht me banorët e fshatit Dumnicë dhe fshatrave përreth, takimi i mbajtur në shkollën “Lasgush Poradeci”**

**- 09.09.2025 – Ora 17:00**

<b>Kërkesat /Sugjerimet / Komentet</b>	<b>Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025</b>	<b>Statusi i kërkesës:  Pranuar  Refuzuar  Adresuar</b>	<b>Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)</b>	<b>Drejtoria:</b>
1.Kërkesë që lagjia “Azem Beqiri” të kyçet në rrjet të ujësjellësit, sepse nuk ka ujë, a mundet komuna të na ndihmojë?	Besiana Beqiri	Adresuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij problemi nuk është kompetencë e Komunës së Podujevës, është kompetencë e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “KRU PRISHTINA”, andaj komuna këtë kërkesë do ta adresojë te kompania përkatëse.	KRU “PRISHTINA”
2.Kërkesë për furnizim me ujë, kyçje në ujësjellës, sepse nuk kemi ujë.	Atdhetare Zymeri	Adresuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij problemi nuk është kompetencë e Komunës së Podujevës, është kompetencë e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “KRU PRISHTINA”, andaj komuna këtë kërkesë do ta adresojë te kompania	KRU “PRISHTINA”

			përkatëse.	
3. Kërkesë për ndriçim në lagjen “Maliq Zymeri”, sepse ska ndriçim.	Atdhetare Zymeri	Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kërkesa është nën kompetencën e Komunës, gjegjësisht drejtorisë së Shërbimeve Publike, grupi punues pas një konsultimi me drejtorinë e lartë përmendur ka vlerësuar se kjo kërkesë është e rëndësishme për banorët e Dumniës dhe si e tillë do të përfshihet në buxhetin e vitit 2026.	DSHPMSH
4.Kërkesë për të shtruar me zhavor rrugën afër stallës time, kam disa krerë lope dhe është e nevojshme për mua si blegtor.	Bajram Miftari	Refuzuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij problemi është kompetencë e Komunës së Podujevës, saktësisht drejtorisë së Shërbimeve Publike, mirëpo grupi punues ka pas rishikimit të buxhetit kanë vlerësuar se nuk ka mjete të mjaftushme për të realizuar këtë kërkesë.	DSHPMSH

Të vendoset tabela e adresimit të komenteve nga platforma e konsultimeve publike

Në platformën e konsultimeve publike nuk kemi pasur asnjë kërkesë apo sygjerim.

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës:  Pranuar  Refuzuar  Pjesërisht Adresuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
0	/	/	/	/

**Të vendoset tabela nga kërkesat e pranuar me email;**

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës:  Pranuar  Refuzuar  Adresuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
/	/	/	/	/

**Shkurtesat:**

F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali, P-Pranuar, R-Refuzuar, PJ-Pjesërisht.

**Shkurtesat e drejtorive:**

**DSHPMSH** - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim; **DPUMM**, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, **DKA**, Drejtoria Komunale e Arsimit.

**Aneks 3 (Njoftimet e publikuar në kuadër të dëgjimeve buxhetore)**

Nr	Përmbajtja	Linku
1.	Ftesa/njoftimi për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor	<a href="https://www.facebook.com/share/p/1CGQQBKBp8/">https://www.facebook.com/share/p/1CGQQBKBp8/</a> <a href="https://podujeve.rks-gov.net/news/rikujtim-sot-mbahet-takimi-me-qytetare-ne-fshatin-gllamnik-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/">https://podujeve.rks-gov.net/news/rikujtim-sot-mbahet-takimi-me-qytetare-ne-fshatin-gllamnik-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/</a> <a href="https://podujeve.rks-gov.net/news/rikujtim-sot-mbahet-takimi-me-qytetare-ne-fshatin-dumnice-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/">https://podujeve.rks-gov.net/news/rikujtim-sot-mbahet-takimi-me-qytetare-ne-fshatin-dumnice-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/</a>
2.	Kalendari për dëgjimet buxhetore 2026	<a href="https://podujeve.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjimet-buxhetore-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/">https://podujeve.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjimet-buxhetore-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/</a>
3.	Qarkorja buxhetore	<a href="https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Draft-Qarkorja-Buxhetore-2026-01_SE-komente_07052025.-shqip-2.pdf">https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Draft-Qarkorja-Buxhetore-2026-01_SE-komente_07052025.-shqip-2.pdf</a>

#### Aneks 4 (Materialet e përgadituara për dëgjime Buxhetore në Podujevë)

Nr	Përmbatja	Linku/material
1.	Njoftimet dhe rikujtime për secilin dëgjim publik në facebook	<a href="#">Facebook</a>
2.	Lajmi në ueb faqe zyrtare	<a href="https://podujeve.rks-gov.net/news/komuna-e-podujeves-ka-nisur-degjimet-publike-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/">https://podujeve.rks-gov.net/news/komuna-e-podujeves-ka-nisur-degjimet-publike-per-propozimbuxhetin-e-vitit-2026/</a> <a href="https://podujeve.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-publik-per-propozimbuxhetin-2026-ne-fshatin-dumnice/">https://podujeve.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-publik-per-propozimbuxhetin-2026-ne-fshatin-dumnice/</a>
3.	Njoftimi në rrjetet sociale nga dëgjimi	<a href="https://www.facebook.com/share/p/1BytZmXuWL/">https://www.facebook.com/share/p/1BytZmXuWL/</a>
4.	Procesverbali nga dëgjimi buxhetor	<a href="https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/DUMNICE-Procesverbali-i-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-finaloo.pdf">https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/DUMNICE-Procesverbali-i-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-finaloo.pdf</a> <a href="https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/GLLAMNIK-Procesverbali-i-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-finaloo-2.pdf">https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/GLLAMNIK-Procesverbali-i-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-finaloo-2.pdf</a>

## **Përfundimi**

Komuna jonë me kohë dhe brenda afateve ligjore ka formuar grupin punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2026-2028 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2026, po ashtu kemi hartuar me kujdes të shtuar kalendarin shtrirjen horizontale të dëgjimeve buxhetore në tërë territorin e komunës së Podujevës, si në zonat rurale ashtu edhe në qytet.

Për të gjitha dëgjimet kemi ruajtur kujdesin që të hartojmë procesverbalet me kërkesat e bëra nga ana e qytetarëve të pranishëm në dëgjim dhe në fund fare kemi hartuar edhe raportin final me të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe ne si komunë u jemi përgjigjur në formë të shkruar në raport pranimit të kërkesave, refuzimit ose të pranuar pjesërisht.